



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:334856
Datë: 19.02.2025
Numri i dokumentit: 06872079

C.nr.1296/24

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.G nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson avokati Z.H nga Prishtina, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Shëndetësisë, për kompensimin e pagës së 13-të, vlera e kontestit 1,169.00 euro, jashtë seancës, me datë 19.02.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit I.G nga Rahoveci, në lidhje me këtë çështje juridike.

A r s y e t i m

Paditësi I.G nga Rahoveci, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Z.H nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Shëndetësisë, për kompensimin e pagës së 13-të, vlera e kontestit 1,169.00 euro.

Përfaqësuesi i autorizuar e paditësit me parashtrësën e datës 04.02.2025, e ka tërhequr padinë ndaj të paditurit të lartcekur.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke pas parasysh edhe tërheqjen e padisë ka ardhur në përfundim se padia e paditësit të konstatohet e tërhequr në kuptim të nenit 261 paragraf 1 të LPK-së, i cili e përcakton se *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi...”*.

Nga arsyet e cekura më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387 paragraf 1 pikë c) të LPK –së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Civil,
C.nr.1296/24, me datë 19.02.2025.

Gj y q t a r i
Avni Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, konform nenit 261.4 të LPK-së.